



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 15.03.2019]

- 1. Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Be Is” shpk (53%), me NIPT K71412003A, me adrese: Kukës, Lagjja nr 1, pallati Metalurgu, hyrja nr 1, & “2T” shpk (45%), me NIPT K01731001M, me adrese: Rruga “Asim Vokshi”, ndertesa 14, hyrja 4, apartamenti 5, Tirane, & “Viante Konstruksion” shpk (2%), me NIPT K47103804L, me adrese: “Gramsh Sporti”, Gramsh.**

Procedura e prokurimit: **“Tender i Hapur”** me objekt : **“Rikonstruksion i Sheshit Taulantia Bashkia Durres”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i Sheshit Taulantia Bashkia Durres”**.

Numri i referencës së procedurës: **REF-94424-11-15-2018**.

Kohëzgjatja: brënda 18 muaj nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: **362.816.046** (treqind e gjashtëdhjetë e dy milion e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyzet e gjashtë) lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 17.12.2018**.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	NIPTI	OFERTA PA TVSH
1	"VELLEZERIT HYSA" SHPK	K12911201C	245,828,961
2	"XH&M" SHPK	J91825009L	251,457,317
	"NDREGJONI" SHPK	K31329048I	
3	"KEVIN KONSTRUKSION" SHPK	K71401004W	275,634,844
	"VEGA" SHPK	K01524006L	
4	"DELTA LAVORI" SHPK	L62415021P	270,797,911
	"COMPANY RIVIERA 2008" SHPK	K81716011V	
	"DAJTI PARK" SHPK	K11507003S	
5	"BE IS" SHPK	K71412003A	284,308,036
	"2T" SHPK	K01731001M	
	"VIANTE KONSTRUKSION" SHPK	K47103804L	
6	"GPG COMPANY" SHPK	J64324443V	288,263,002
7	"ARIFAJ" SHPK	J76418907K	305,160,223
8	"SALILLARI" SHPK	J62903125G	313,524,480
9	"CURRI" SHPK	J67902718S	321,503,054
10	"IZOBAR CONSTRUCTION" SHPK	L12210036D	PA OFERTE

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

1. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Vellezerit Hysa” shpk pasi:

Ne daten 14.01.2019, me shkresen nr. 49 prot, kjo shoqeri ka deklaruar se terhiqet nga procedura e tenderit.

2. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Xh&M” shpk (55%) dhe “Ndregjoni” shpk (35%) pasi:

Ne marreveshjen e bashkepunimit ndermjet dy shoqerive nuk jane percaktuar punet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri, ne perputhje me nenin 74, pika 2 te VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku shprehimisht citohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës”*. Per rrjedhoje, duke qene se per disa nga kerkesat per kualifikim shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur behet ne raport me punet konkrete qe merr persiper secili anetar i bashkimit, komisioni i vleresimit te ofertave e ka te pamundur te procedoje me shqyrtimin e detajuar te gjithe dokumentacionit.

Bashkimi i Operatoreve Ekonomike nuk ka paraqitur grafikun e detajuar te punimeve duke parashikuar vleren e plote te punimeve pa tvsh per cdo muaj, sic eshte kerkuar ne shtojcen 13 te Dokumentave te Tenderit. Grafiku i paraqitur eshte i pa plotesuar.

Shoqeria “Xh&M” shpk nuk ploteson piken 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin minimal te te punesuarve, pasi, bazuar ne dokumentacionin e paraqitur, rezulton se numri i te punesuarve te kesaj shoqerie eshte: Prill: 32, Maj: 34, Qershor: 41, Korrik: 51, Gusht: 85, Shtator: 52 dhe Tetor: 48. Bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper sipas marreveshjes se bashkepunimit (55%) duhet te kete minimalisht 47 persona dhe nuk ploteson per muajt prill, maj dhe qershor.

Shoqeria “Ndregjoni” shpk nuk ploteson piken 2.3.8 per kualifikim lidhur me disponimin e pikave te kerkuara te licenses, pasi nuk ploteson germen E per NP4 dhe germen B per NP 8. Duke qene se nuk jane percaktuar punet qe do te kryeje secila shoqeri dhe nuk ploteson kete kerkese, komisioni konsideron se nuk plotesohet kushti per kualifikim.

3. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Kevin Konstruktion” shpk (30.22%) dhe “Vega” shpk (69.78%) pasi:

Shoqeria “Kevin Konstruktion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi referuar puneve te ngjashme te deklaruar ka kryer aktivitet ne Kukes ne objektin “Rruga Borje – kufi me Kosovën” dhe nuk ka paguar detyrimet vendore.

Shoqeria “Kevin Konstruktion” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme pasi ka paraqitur dy kontratat: “Rikualifikim urban i bllokut kufizuar nga rruga “Ibrahim Rugova”, “Pjeter Bogdani” “Gjin Bue Shpata” dhe bulevardi “Bajram Curri” me vlere 39.762.162 leke pa tvsh dhe “Rruga Borje – kufi me Kosoven” me vlere 53.317.647 leke pa tvsh.

Me keta dy objekte nuk ploteson asnje prej kushteve pasi vlere e objektit me te madh te deklaruar eshte

53.317.647 leke pa tvsh nga 54.821.504 leke pa tvsh qe eshte kerkesa dhe vlere e plote e te dy objekteve te deklaruar eshte 93.079.809 leke pa tvsh nga 219.286.018 leke pa tvsh qe eshte kerkesa (bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper).

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

4. Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Delta Lavori” dege e shoqerise se huaj (64,42%) “Company Riviera 2008” shpk (24,94%) dhe “Dajti Park” shpk (10,64%) pasi:

Bashkimi i shoqerive ka paraqitur nje oferte me vlere 278.221.219 leke pa tvsh, nderkohe qe pas kontrollit aritmetik dhe korigjimit te gabimeve aritmetike rezultoi se vlere e ofertuar eshte 270.797.911 leke. Vlere absolute e gabimit aritmetik eshte 7.423.308 leke ose 2,7%, me e madhe se 2%. Bazuar ne nenin 66, pika 4 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ku, nder te tjera, citohet: “Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumet absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se $\pm 2\%$ e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar” oferta e ketij bashkimi shoqerish refuzohet. Gabimi aritmetik ju be i ditur perfaqesuesit te shoqerise “Delta Lavori” shpk (shoqeria kryesuese e bashkimit) dhe ai pranoi gabimin pa verejtje.

5. Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Izobar Construction” shpk pasi:

Nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per kualifikim.

Plotesojne kerkesat per kualifikim:

2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Be Is” shpk (53%) & “2T” shpk (45%) & “Viante Konstruksion” shpk (2%).
3. Shoqeria “GPG Company” shpk
4. Shoqeria “Arifaj” shpk
5. Shoqeria “Salillari” shpk
6. Shoqeria “Curri” shpk

Komisioni kontrolloi nese ofertat jane anomalisht te uleta dhe konstatoi se ofertat nuk jane anomalisht te uleta.

Ne perfundim komisioni vendosi te beje renditjen e meposhtme:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH	RENDITJA
1	Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Be Is” shpk (53%) & “2T” shpk (45%) & “Viante Konstruksion” shpk (2%)	284.308.03 6	RENDITET NE VEND TE PARE
2	Shoqeria “GPG Company” shpk	288.263.00	RENDITET NE VEND TE DYTE
3	Shoqeria “Arifaj” shpk	305.160.22	RENDITET NE VEND TE TRETE
4	Shoqeria “Salillari” shpk	313.524.48	RENDITET NE VEND TE KATERT
5	Shoqeria “Curri” shpk	321.503.05	RENDITET NE VEND TE PESTE

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Be Is” shpk (53%), me NIPT K71412003A, me adrese: Kukes, Lagjja nr 1, pallati Metalurgu, hyrja nr 1, & “2T” shpk (45%), me NIPT K01731001M, me adrese: Rruga “Asim Vokshi”, ndertesa 14, hyrja 4, apartamenti 5, Tirane, & “Viante Konstruksion” shpk (2%), me NIPT K47103804L, me adrese:

“Gramsh Sporti”, Gramsh, me kryesuese shoqerine “Be Is” shpk, se oferta e paraqitur, me vlerë **284.308.036 (dyqind e tetedhjetë e kater milion e treqind e tete mije e tridhjetë e gjashtë)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit ligjor nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **14.01.2019**.

Ne daten 18.01.2019 paraqiti ankimi bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Xh&M” shpk (55%) dhe “Ndregjoni” shpk (35%). Ankimit ju kthye pergjigje ne daten 23.01.2019 duke e refuzuar ate.

Ne daten 21.01.2019 paraqiti ankimi Operatori Ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk. Ankimit ju kthye pergjigje ne daten 21.01.2019 duke e refuzuar ate.

Ne daten 01.02.2019 bashkimi i Operatoreve Ekonomike “Xh&M” shpk (55%) dhe “Ndregjoni” shpk (35%) paraqiten ankimi ne KPP.

Autoriteti Kontraktor me shkresen nr.95/3, date 06.02.2019, dorezoi prane K.P.P informacionin e kerkuar ne lidhje me kete procedure prokurimi.

Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin K.P.P.134/2019, vendosi te mos pranoje ankimin e paraqitur nga BoE “Xh&M” shpk dhe “Ndregjoni” shpk sh.p.k, dhe lejimin nga ana e Autoritetit Kontraktor per vijimin me hapat e metejshme te procedures